

**BROSHURË MBI PROCEDURAT
RAJONALE STANDARDË TË VEPRIMIT PËR
IDENTIFIKIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT
DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË
TRAFIKIMIT NË SITUATA EMERGJENTE**





TABELA E PËRMBAJTJES

SI SHËRBEN KJO BROSHURË SI BURIM PËR PROFESIONISTËT.....	1
AKTORËT PËRGJEGJËS PËR ZBATIMIN E PSV-ve RAJONALE.....	1
STRUKTURA DHE HAPAT E PSV-ve.....	2
NJOHJA FILLESTARE.....	2
IDENTIFIKIMI PARAPRAK.....	4
IDENTIFIKIMI FORMAL.....	5
TREGUESIT PËR IDENTIFIKIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMI.....	8

LISTA E SHKURTIMEVE

ON MARRI	Organizatë Ndërkombëtare
Pjesëmarrësit e MARRI-t	Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (Referuar 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova*)
OJQ	Organizata joqeveritare
QPS	Qendra për mirëqenie sociale
PK	Personi/pika e kontaktit
VMT	Viktimat e Mundshme të Trafikimit
PSV	Procedura Standarde e Veprimit
TQNj	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
MRT	Mekanizmi Transnacional i Referimit
VT	Viktimat e Trafikimit

* Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet në lidhje me statusin dhe është në përputhje me rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) dhe qëndrimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

1. SI SHËRBEN KJO BROSHURË SI BURIM PËR PROFESIONISTËT

Reagimi ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në situata emergjente është një aktivitet që mbron dhe shpëton jetë.

Krizat ndikojnë te trafikimi i qenieve njerëzore, gjithashtu në rajonet që strehojnë migrantët si vende tranziti apo destinacioni.

Zhvillimi i PSV-së Rajonale (Procedura Standarde e Veprimit) për identifikimin e VT-ve (Viktimave të Trafikimit) dhe VMT-ve (Viktimave të Mundshme të Trafikimit) në situata emergjente kontribuon në krijimin e një procedure të unifikuar, të standardizuar dhe të harmonizuar për identifikimin e VT-ve dhe VMT-ve në situata emergjente.

Është një instrument dhe një burim i dobishëm për të gjithë profesionistët përkatës të përfshirë në procesin e identifikimit të VMT-ve dhe VT-ve në situata emergjente.

Qëllimi i kësaj broshure është të ndihmojë të gjithë profesionistët nga Pjesëmarrësit e MARRI-t që mund të kontaktojnë VT-të dhe VMT-të në procesin e identifikimit të shpejtë gjatë situatave emergjente.

2. AKTORËT PËRGJEGJËS PËR ZBATIMIN E PSV-ve RAJONALE

Profesionistët në frontin e parë: oficerë policie, punonjës socialë, profesionistë të kujdesit shëndetësor, përkthyes, profesionistë nga OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe të tjera.

Koordinator për identifikimin e viktimave të trafikimit, një profesionist që ka punuar më parë në procesin e identifikimit formal të viktimave të trafikimit dhe është përgjegjës për koordinimin e procedurës së

identifikimit formal në situata emergjente.


Personi/pika e kontaktit (PK) për identifikimin e rasteve të TQNj-së në situata emergjente (referuar si PK për TQNj-në) - një profesionist i trajnuar posaçërisht nga policia dhe/ose shërbimet sociale në dispozicion 24 orë për të qenë i pranishëm në terren me kërkesë të çdo profesionisti që identifikon VT-të dhe/ose VMT-të bazuar te treguesit për identifikim.

3. STRUKTURA DHE HAPAT E PSV-së

Ndërveprimet në të gjitha fazat e procesit të identifikimit duhet të bazohen në elementët e mëposhtëm:



PSV-ja Rajonale përshkruan procedurat, të cilat përbajnë udhëzimet e tyre lidhur me:



4. NJOHJA FILLESTARE

ÇFARË: Kontakti i parë i drejtpërdrejtë i personave në rrezik, migrantëve dhe refugjatëve gjatë situatave emergjente me autoritetet ose përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve, për të cilët mund të lindnin dyshime për TQNj bazuar te treguesit për identifikimin e VT-ve dhe VMT-ve (që gjenden në fund të dokumentit) dhe rrethanat e situatës që kanë hasur.

KUSH: Të gjithë reaguesit e frontit të parë nga Pjesëmarrësit e MARRI-t.

KUR: Gjatë dhe pas kontaktit fillestar me personin që supozohet të jetë VT ose VMT.

SI:

- Përgatitet raporti për çdo person;
- Kryhet kontrolli paraprak shëndetësor;
- Forcat e rendit vihen në kërkim të shenjave të mundshme të veprave penale (TQNj, Kontrabandë etj.)
- Frontex dhe/ose forcat e rendit kryejnë intervistat e vlerësimit paraprak;
- Procesi kryhet bazuar te treguesit dhe intervistat e vlerësimit paraprak, VMT-të dhe VT-të e njohura/identifikuara fillimisht;
- Personat ndahen nga grupi/personat e tjerë;
- Personat informohen për të drejtat e tyre dhe pyeten nëse ata dëshirojnë ta raportojë çështjen në polici dhe nëse personat janë dakord
- ndihmojini ata për ta bërë këtë gjë;
- Procesi i identifikimit vazhdon nëse personat janë dakord (me kusht që personat të jenë adultë);
- Në rast se kemi të bëjmë me një të mitur, informohet menjëherë QPS-ja;
- Nëse personi adult, për të cilin dyshohet se është VT, nuk jep pëlqimin për procesin e identifikimit, PK-ja Lokale për TQNj-në përgatit një përmbledhje të shkurtër dhe ia dërgon atë Koordinatorit Lokal për identifikimin e viktimave të trafikimit (Formulari 1), i cili pastaj e ndan atë me Koordinatorët Lokalë të pjesëmarrësve të MARRI-t për TQNj-në, prej nga ka ardhur personi dhe/ose deri ku supozohet se do të shkojë personi;
- Koordinatorët Lokalë për identifikimin e viktimave të trafikimit nga pjesëmarrësit e informuar të MARRI-t ndajnë më tej informacionin e marrë në nivel lokal (procesi i shkëmbimit të informacionit nga pika e parë deri në pikën e fundit fillon brenda 24 orëve);
- Nëse personi që supozohet të jetë VT dëshiron të aplikojë për azil, profesionistët e frontit të parë informojnë profesionistët përkatës të azilit në lidhje me të gjitha informacionet e disponueshme deri në atë pikë.

5. IDENTIFIKIMI PARAPRAK

ÇFARË: Ndërmarrja urgjente e një sërë veprimesh në bazë të të cilave mund të supozohet se personi është VT dhe mund të ndërmerret masat për mbrojtjen fillestare të tij.

KUSH: PK-ja lokale për TQNj-në kryen identifikimin paraprak të VT-ve.

KUR: Procesi fillon menjëherë pas identifikimit fillestar dhe informohet PK-ja lokale për TQNj-në. Ai/ajo shkon në terren sa më shpejt të jetë e mundur dhe kryen procedurën për identifikimin dhe referimin paraprak (kjo procedurë kryhet në përputhje me protokollet mjekësore të zbatuar në çdo pjesëmarrës të MARRI-t).

SI: Profesionisti që dyshon se personi/personat janë VMT njofton menjëherë PK-në lokale për TQNj-në (PK-ja lokale për TQNj-në mund të marrë gjithashtu informacione të tilla nga Koordinatori Lokal për identifikimin e viktimave të TQNj-së që i ka marrë informacionet nga Pjesëmarrësit e tjerë të MARRI-t).

- PK-ja lokale për TQNj-në shkon në terren dhe takon profesionistin dhe merr informacion;
- Personi njoftohet menjëherë për konfidencialitetin, të drejtën e tij për të marrë vendime të informuara dhe qëllimin e intervistës;
- Nëse personi është një i mitur, duhet të kontakohet Qendra kompetente për Punë Sociale që po merret me çështjen dhe që përfaqëson të miturin;
- Pasi merret pëlqimi i personit, është e rëndësishme të vlerësohet nëse ky person është në gjendje të marrë pjesë në një intervistë;
- Nëse konstatohet se personi nuk është në gjendje të intervistohet, PK-ja Lokale për TQNj-në do ta referojë personin për shërbimet e nevojshme mbështetëse.
- PK-ja Lokale vlerëson se personi është në gjendje të bëjë intervistën, atëherë kryhet intervista;

Bazuar tek rezultatet e intervistës, PK-ja Lokale për TQNj-në mund të arrijë në përfundimet e mëposhtme:

- Personi ka rrezik të lartë të jetë VT ose
- Personi ka rrezik të ulët të jetë VT;
- Nëse personi ka rrezik të lartë të jetë VT, PK-ja Lokale për TQNj-në njofton menjëherë Koordinatorin Lokal për identifikimin e viktimave të trafikimit dhe bien dakord për një plan referimi (MKR-ja për çdo Pjesëmarrës të MARRI-t);
- Nëse personi ka rrezik të ulët ose të lartë dhe ai/ajo refuzon çdo mbështetje dhe mbrojtje, hartohet shënimi zyrtar dhe nënshkruhet nga personi dhe së bashku me të gjitha informacionet e marra dërgohen nga Koordinatori Lokal për identifikimin e viktimave të trafikimit te Koordinatorët Lokalë për identifikimin e viktimave të trafikimit në pjesëmarrësit e tjerë të MARRI-t.

6. IDENTIFIKIMI FORMAL

ÇFARË: Procedurë e bazuar në një vlerësim të kryer nga autoriteti kompetent me të cilin një person merr statusin e viktimës në përputhje me mekanizmin e caktuar të identifikimit formal në çdo pjesëmarrës të MARRI-t.

KUSH: Koordinator Lokal për identifikimin e viktimave të trafikimit.


KUR: Brenda 24 orëve nga identifikimi paraprak (në rrethana të veçanta si në rastin e pandemive, ky afat kohor mund të zgjatet).

SI:

- Pas identifikimit paraprak, PK Lokal për TQNj-në i dorëzon Koordinatorit Lokal informacion për identifikimin;
- Nëse është e mundur, identifikimi formal mund të kryhet në bazë të informacionit të mbledhur dhe pa përsëritjen e intervistës;
- Në përputhje me MKR-në e Pjesëmarrësit të MARRI-it, Koordinatori Lokal për identifikimin e viktimave të trafikimit do të

- referojë personin/personat në akomodimin e përshtatshëm, do të koordinojë zhvillimin dhe zbatimin e planit individual afatshkurtër për mbështetje dhe mbrojtje;
- Nëse Koordinatori Lokal për identifikimin e VT-ve konstaton se personi nuk mund të intervistohet dhe nuk është e mundur të marrë një vendim në bazë të informacionit që ka në dispozicion pa kryer intervistë, procedura për identifikimin formal do të rifillojë kur personi të jetë në gjendje të intervistohet;
- Nëse gjatë procesit të identifikimit formal, konstatohet se personi/personat janë VT, komunikimi i mëtejshëm ndërmjet pjesëmarrësve të MARRI-t do të organizohet në bazë të Procedurave Transnacionale për Referime.

Grafiku: PSV-ja Rajonale për Identifikimin e VT-ve në Situata Emergjente





7. TREGUESIT PËR IDENTIFIKIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

TREGUESIT PËR IDENTIFIKIMIN E TË RRITURVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

TREGUESIT E PËRGJITHSHËM

Treguesit që marrin në konsideratë migrimin:

- Kalon një kohë të gjatë në vendin tranzit;
- I/e zhgënjyer nga premtimet e rreme dhe ka pritshmëri jorealiste nga vendi i destinacionit;
- Histori që nuk përkohet për rrugën e migracionit, nuk ka njohuri për rrugën e udhëtimit nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit;
- Ndryshimi i historisë për udhëtimin, zvogëlimi i seriozitetit të situatës, rrëfimi i historive të njëjta si migrantët nga i njëjti vend origjine;
- Borxhi i konsiderueshëm ndaj kontrabandistëve, borxhi vazhdon të rritet me kalimin e kohës;
- Personi nuk e ka idenë se ku është.

Treguesit për të gjithë personat e trafikuar:

- Besojnë se ata duhet të punojnë kundër vullnetit të tyre;
- Tregojnë shenja se lëvizjet e tyre po kontrollohen;
- Tregojnë frikë ose ankth;
- Përjetojnë dhunë ose kërcënime për ushtrim dhune ndaj tyre ose ndaj anëtarëve të familjes dhe njerëzve të tyre të dashur;
- Pësojnë lëndime që duket se vijnë si rezultat i një sulmi;
- Pësojnë lëndime ose dëmtime që janë tipike për punë ose masa të caktuara kontrolli;
- Pësojnë lëndime që duket se vijnë si rezultat i zbatimit të masave të kontrollit;

- Nuk kanë besim tek autoritetet;
- Kërcënohen se do t'u dorëzohen autoriteteve;
- Kanë frikë të zbulojnë statusin e tyre të imigrimit;
- Nuk zotërojnë pasaportën ose dokumente të tjera udhëtimi ose identifikimi, pasi ato dokumente mbahen nga dikush tjetër;
- Keni dokumente të rreme identiteti ose udhëtimi;
- Gjenden ose lidhen me një lloj vendndodhjeje që ka gjasa të përdoret për të shfrytëzuar njerëz;
- Nuk dinë gjuhën vendase;
- Nuk dinë adresën e shtëpisë ose të punës;
- I lejojnë të tjerët të flasin në emër të tyre kur ju drejtohen drejtpërdrejt;
- Veprojnë sikur të ishin udhëzuar nga dikush tjetër;
- Detyrohen të punojnë në kushte të caktuara;
- Disiplinohen përmes ndëshkimit;
- Nuk janë në gjendje të negociojnë kushtet e punës;
- Paguhet pak ose aspak;
- Nuk kanë akses te të ardhurat e tyre;
- Nuk kanë akses te shërbimet e kujdesit mjekësor;
- Ndërveprojnë pak ose aspak me shoqërinë;
- Kanë kontakte të kufizuara me familjet e tyre ose me njerëz që nuk kanë lidhje me mjedisin e tyre të afërt;
- Nuk janë në gjendje të komunikojnë lirisht me të tjerët;
- Janë të varur nga dikush;
- Vijnë nga një vend që njihet si burim i trafikimit të qenieve njerëzore;
- Kostot për transportin e tyre në vendin e destinacionit janë paguar nga lehtësuesit, të cilëve duhet t'ua shpagojnë duke punuar ose ofruar shërbime në destinacion;
- Kanë vepruar në bazë të premtimeve të rreme.

Trafikimi për qëllime shfrytëzimi seksual:

- Personi nuk e ka idenë se ku ndodhet;
- Ka kryer akte seksuale me qëllim fitimi në vende të njohura si vende tranziti që përdoren nga trafikantët;
- Kombësia e rrezikuar: vjen nga një vend që njihet për rrjetet e

tij të trafikimit me qëllim shfrytëzimin seksual (vendet e Evropës Lindore, Nigeria, etj.);

- Janë të çdo grupmoshe, megjithëse moshë mund të ndryshojë sipas vendndodhjes dhe tregut;
- Lëvizin nga një shtëpi publike në tjetrën ose punojnë në vende të ndryshme;
- Shoqërohen kurdo që shkojnë dhe kthehen nga puna dhe aktivitete të tjera të jashtme;
- Kanë tatuazhe ose shenja të tjera që tregojnë “zotërimin” nga shfrytëzuesit e tyre;
- Punojnë me orë të gjata ose kanë pak ose aspak ditë pushimi;
- Flenë aty ku punojnë;
- Jetojnë ose udhëtojnë në grup, ndonjëherë me gra të tjera, të cilat nuk flasin të njëjtën gjuhë;
- Kanë shumë pak veshje;
- Kanë rroba të llojit që kryesisht vishen nga punëtorët e seksit;
- Dinë të thonë vetëm fjalë që lidhen me seksin në gjuhën lokale ose në gjuhën e grupit të klientëve;
- Nuk kanë para të tyre;
- Nuk kanë dokument identifikimi.

Treguesit e mëposhtëm mund të tregojnë gjithashtu se fëmijët janë trafikuar:

- Ka prova që viktimat e supozuara kanë kryer seks të pambrojtur dhe/ose të dhunshëm;
- Ka prova që viktimat e supozuara nuk mund të refuzojnë të kryejnë seks të pambrojtur dhe/ose të dhunshëm;
- Ka prova se një person është blerë dhe shitur;
- Nuk kanë mundësi zgjedhjeje për akomodimin;
- Nuk dalin asnjëherë nga ambientet e punës pa punëdhënësin e tyre;
- Nuk mund të lëvizin lirisht;
- Ndëshkohen me gjoba;
- Përjetojnë fyerje, abuzime, kërcënime ose dhunë;
- Nuk kanë kryer trajnimet bazë dhe nuk kanë licencat profesionale.

Treguesit e mëposhtëm mund të tregojnë gjithashtu se njerëzit janë trafikuar për shfrytëzim në punë:

- Nuk ka njoftime për shëndetin dhe sigurinë;
- Punëdhënësi ose menaxheri nuk është në gjendje të tregojë dokumentet e nevojshme për punësimin e punëtorëve nga vende të tjera;
- Punëdhënësi ose menaxheri nuk është në gjendje të tregojë të dhënat e pagave të paguara për punëtorët;
- Pajisjet e shëndetit dhe sigurisë janë të cilësisë së dobët ose mungojnë;
- Pajisja është projektuar ose modifikuar në mënyrë që të mund të përdoret nga fëmijët;
- Ka prova se po shkelet legjislacioni i punës;
- Ka prova se punëtorët duhet të paguajnë për mjetet, ushqimin ose akomodimin ose se këto kosto iu mbahen nga paga e tyre.

Njerëzit që janë trafikuar me qëllim që të lypin ose të kryejnë krime të vogla, mund:

- Të jenë fëmijë, të moshuar ose migrantë me aftësi të kufizuara;
- Të jenë fëmijë që mbajnë dhe/ose shesin droga të paligjshme;
- Të kenë dëmtime fizike që duket se vijnë si rezultat i gjymtimit;
- Të jenë fëmijë me të njëjtën kombësi ose etni që lëvizin në grupe të mëdha me vetëm disa të rritur;
- Të jenë të mitur të pashoqëruar që janë “gjetur” nga një i rritur i së njëjtës kombësi ose etni;
- Të lëvizin në grup kur përdorin transportin publik;
- Të marrin pjesë në aktivitetet e bandave të organizuara kriminale;
- Të jenë pjesë e grupeve të mëdha të fëmijëve që kanë të njëjtin kujdestar të rritur;
- Të dënohen nëse nuk mbledhin ose vjedhin mjaftueshëm;
- Të jetojnë me anëtarët e bandës së tyre;
- Të udhëtojnë me anëtarët e bandës së tyre drejt vendit të destinacionit;
- Të jetojnë, si anëtarë bande, me të rritur që nuk janë prindërit e tyre;
- Të lëvizin çdo ditë në grupe të mëdha dhe në distanca të konsiderueshme.

TREGUESIT PËR IDENTIFIKIMIN E TË MITURVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Treguesit e përgjithshëm për të gjithë të miturit:

- Nuk ka informacion të qartë për vendin e destinacionit;
- Ka udhëtuar me një të rritur që nuk është prindi ose kujdestari ligjor i saj/tij;
- Raporte të përsëritura për veprimtari të paligjshme;
- Të miturit që punojnë në rrugë: shesin sende (cigare, gazeta, pije, lodra, lule, etj.);
- Ia mbath nga strehëzat/akomodimi;
- Mungesa në shkollë ose braktisja e saj;
- Është i/e angazhuar në punë që nuk i përshtaten moshës së tij/saj;
- Nuk ka kohë për të luajtur;
- Nuk ka miq të së njëjtës moshë jashtë punës;
- Gënjën për moshën e tij/saj për t'i shpëtuar sistemit kombëtar të mirëqenies së fëmijëve;
- Përdor drogë dhe/ose alkool;
- Është pjesë e një grupi të miturish që kontrollohen nga një i rritur ose një fëmijë më i madh;
- Nuk ka akses te kujdestarët ligjorë;
- Kur i mituri është i shoqëruar, shoqëruesi mund të prezantohet si një i afërm ose familjar, por gjatë intervistës duket sikur nuk njihen realisht dhe japin informacione kontradiktore për rrugën e migrimit dhe destinacionin përfundimtar;
- Vjen në një takim bashkë me një të rritur që dëshiron të marrë pjesë në intervistë;
- Vjen ta marrë një i rritur direkt pas intervistës ose takimit;
- Nuk sillen siç sillen zakonisht fëmijët e së njëjtës moshë (d.m.th., është jashtëzakonisht i frikësuar ose i shoqërueshëm, shfaq sjellje eksplicite seksuale, etj.);
- Duket se po krijon marrëdhënie jo të shëndetshme me të rriturit;


- Sjellja e pazakontë e fëmijës ndaj personit që e shoqëron (i shqetësuar, i frikësuar);
- Duket qartë se është i rreskapitur dhe në një gjendje alarmante me higjienë të dobët;
- Fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë prezantohen si vëllezër e motra kur duket se nuk kanë asnjë ngjashmëri apo lidhje emocionale;
- Përvoja e migrimit;
- Jeta e përditshme lidhet me shfrytëzimin;
- Mjetet e kontrollit të përdorura nga trafikantët.

Shfrytëzimi seksual:

- Të mitur shtatzënë;
- Rroba me masa për fëmijë të veshura përgjithësisht nga punëtorët e seksit;
- Të mitur të pashoqëruar që mbajnë numra telefoni për të thirrur taksit;
- Sjellje eksplicite seksuale;
- Prania e lodrave, shtretërve dhe veshjeve për fëmijët në vende të papërshtatshme si shtëpi publike dhe fabrika.

Lypja e detyruar dhe aktivitetet e paligjshme:

- Lëviz çdo ditë në grupe me disa fëmijë, veçanërisht në vende të njohura ose turistike;
- I përket një grupi fëmijësh të së njëjtës kombësi;
- Transporton ose rishet drogë ose produkte të tjera të paligjshme;
- I jepet të hajë vetëm mbetjet e ushqimit;
- Fëmijë me aftësi të kufizuara ose të gjymtuar.



Ky publikim mbështetet nga Projekti Rajonal për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore financuar nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe zbatuar nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) së bashku me partnerin strategjik Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI).

Analizat, rezultatet dhe rekomandimet në këtë publikim përfaqësojnë opinionin e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) apo të Inicativës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI).



Publikuar nga:

Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Selia:

Bonn and Eschborn, Germany

Projekti Rajonal:

Parandalimi dhe Lufta Kundër Trafikimit të
Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor
Martin Hiebsch
Antonie Grubisikj 5
1000 Shkup, Maqedonia e Veriut
T +389 23103560
E martin.hiebsch@giz.de
I www.giz.de/en

Autori:

Bistra Netkova

Dizajnoi:

Brand Union DOO Shkup

Në emër të:

Ministria Federale Gjermane për
Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

Më datë:

Shtator 2022